

VENDIM
Nr. 63, datë 3.2.2017

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ZHVILLIMIT URBAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban, të shtohet fondi prej 148 500 000 (njëqind e dyzet e tetë milion e pesëqind mijë) lekësh, në zërin shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes, për ekzekutimin e vendimit nr. 195 (80-2016-180), datë 25.1.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi nga vendimi nr. 3099, datë 6.10.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ndaj kreditorit, shoqërisë “VEGA” sh.p.k.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2017.
3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi